

**STATUTI I  
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"NEW DENT" SH.P.K.**

**KAPITULLI I**

**KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA DHE OBJEKTI I  
SHOQERISE**

**NENI 1**

**FORMIMI I SHOQERISE**

Shoqeria tregtare "NEW DENT" SH.P.K. me seli qendrore ne adresen: **"Rruga e Kavajes" Kompleksi 21 Square, Shkalla 1, Kati 1, Njesia 4 + Njesia 5, Tirane, Shqiperi** formohet nga ortaket:

**1-Jakup Vrioni** i biri i Luanit, i datelindjes 24.08.1975, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga Rreshit Collaku, Pallati Shallvareve, Shk. 15, Apt. 219, Tirane identifikuar me leternjoftimin nr.H50824031B, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

**2-Medjan Deda** i biri i Idajetit, i datelindjes 01.07.1986, lindur ne Kavaje dhe banues ne Kavaje identifikuar me leternjoftimin nr.I60701115B, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe Aktin e Themelimit, kane vendosur te destinojne ne kete Sipermarrije kapitalin e tyre, me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e Shoqerise, si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne Kapitalin Themeltar.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire.

**NENI 2**

**FORMA, EMERTIMI**

Shoqeria tregtare, eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar. Aktiviteti i kesaj shoqërie rregullohet nga ky status dhe nga Ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar.

Emertimi i Shoqerise eshte: **"NEW DENT" SH.P.K.** Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare, mund te ruhet i njejti emertim, me kusht qe Personi Juridik te shtoje ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.

**NENI 3**

**SELIA, TERRITORI**

Shoqeria Tregtare **"NEW DENT" SH.P.K.**, ka seline qendrore ne territorin e Republikes se Shqiperise ne qytetin e Tiranes, ne adresen: **"Rruga e Kavajes" Kompleksi 21 Square, Shkalla 1, Kati 1, Njesia 4 + Njesia 5, Tirane, Shqiperi.**

Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi apo agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Ajo mund te jete pjesemarrese ne nje shoqeri tregtare apo mund te kontrolloje shoqeri te tjera tregtare si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Njesite strukturore te shoqerise ne format e mesiperme do te krijohen ne perputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit te Republikes se Shqiperise, dhe jashte saj ne perputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendren e vet.

Shoqeria ka vulen e saj.

#### **NENI 4 KOHEZGJATJA**

Shoqeria tregtare **"NEW DENT" SH.P.K.** do te permbushe objektin e veprimtarise se vet me nje **afat te pacaktuar**.

Ndryshimet e shoqerise duke perfshire edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje Personaliteti Juridik te ri.

#### **NENI 5 OBJEKTI VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria **"NEW DENT" Sh.p.k.**, ka si objekt veprimtarie:

1) Ne fushën e sherbimeve stomatologjike, kirurgjise orale – maksilofaciale, estestike dhe bukurise dhe konsulences mjekesore.

### **II. KAPITALI THEMELTAR, KONTIUBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI**

#### **NENI 6 KAPITALI THEMELTAR**

- Kapitali themeltar eshte **100 (njeqind) LEKE**, kapital i cili eshte ne pronesi te ortakeve.
- Ai eshte i ndare ne **100 (njeqind) pjese** te se njejtës kategori me vlere nominale prej **1 (Nje)** leke per çdo pjese.
- Pjeset jane te numertuara nga **1** deri ne **100 (njeqind)** perfshire numrin e fundit te pjeseve. Pjeset nuk materializohen ne letra me vlere te tregtueshme por vërtetohen me ane te te Certifikatave nominative te leshuara nga shoqeria.

Cdo kuote e kapitalit themeltar i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj.

Ortaket e shoqerise perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tij te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

-Ortake te shoqerise "NEW DENT"SH.P.K., jane:

1-Jakup Vrioni i cili zoteron 50% te pjeseve te kapitalit te shoqerise dhe perkatesisht 50 pjese.

2-Medjan Deda i cili zoteron 50% te pjeseve te kapitalit te shoqerise dhe perkatesisht 50 pjese.

## NENI 7

### TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve (ne rast se numri tyre ne te ardhmen do te behet me shume se nje).

Transferimi i pjeseve te kapitalit tek persona te trete dhe/ ose transferimi i pjeseve ne rruge trashegimie, si dhe transferimi tek persona te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri iu nenshtrohet ketyre rregullave:

a. Transferuesi apo trasheguesi ne rastin e transferimit ne rruge trashegimie, duhet t'i njoftoje shoqerise numrin e pjeseve qe do te transferohen, cmimin e shitjes ne rast shitjeje, si dhe emrin, mbiemrin dhe adresen e personit te cilit i transferohen pjeset.

b. Transferimi duhet te miratohet nga Asambleja e ortakeve brenda tre muajve nga dita e njoftimit. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda afatit tre mujor, miratimi quhet i dhene.

c. Asambleja e Ortakeve mund te marre vendim te vlefshem per transferimin vetem kur marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 1/2 e numrit total te votave. Asambleja miraton transferimin vetem me shumicen e ortakeve te pranishem qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e votave.

d. Ne rast se shoqeria refuzon transferimin, brenda tre muajve nga data e refuzimit, ortaket duhet t'i blejne pjeset e pozuar per transferim. Cmimi i shitjes eshte vlere kontabel e pjeseve (book value). Nese disa ortake jane te interesuar njeheresh ne blerjen e pjeseve, e drejta e tyre eshte proporcionale me numrin e pjeseve qe ata zoterojne. Ne rast se asnje ortak nuk eshte i interesuar te bleje pjeset, atehere Asambleja duhet te vendose, me shumicen e ortakeve te pranishem qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e votave, nese: 1. pjeset do t'i shiten personit te propozuar nga transferuesi me cmimin e rene dakort midis tyre; 2. pjeset do t'i shiten nje personi tjetër te trete me cmimin e rene dakort me kete person por jo me pak se vlere kontabel e tyre.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, ne cdo rast, duhet te vertetohet me akt noterial.

## Neni 8

### Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

Asambleja e Ortakeve mund te marre vendim te vlefshem per zmadhirnin e kapitalit themeltar vetem kur marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se  $\frac{1}{2}$  e numrit total te votave. Kapitali themeltar zmadhohet me

vendim te ortakeve te pranishem qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e votave.

Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet me ane te kontributeve te reja ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit.

Ortaket kane te drejten e rritjes ne menyre proporcionale (ne te njejten mase me pjeset e kapitalit qe ata perfaqesojne). Askush nuk mund te favorizohet apo te disfavorizohet nepermjet zmadhimit te kapitalit (parimi i trajtimit te barabarte).

Megjithate, ne asnje rast, ortaket qe perfaqesojne shumicen e cilesuar sipas pikes 11.8. te nenit 11 dhe pikes 9.1. te nenit 9 te ketij statuti, nuk mund te detyrojne nje apo disa ortake te minorances per te rritur angazhimin e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise. Ne kete rast, kapitali rritet ne menyre proporcionale ndermjet ortakeve qe kane pranuar zmadhimin e tij.

Ne rast zmadhimi te kapitalit me ane te kontributeve ne para, te gjitha pjeset e reja duhet te nenshkruhen dhe shlyhen teresisht. Ato duhet te depozitohen nga nenshkruesit per llogari te shoqerise. Terheqja e fondeve te reja mund te behet vetem pas regjistrimit te zmadhimit te kapitalit ne Regjistrin Tregtar.

## Neni 9

### Zvogelimi i Kapitali Themeltar

Asambleja e Ortakeve mund te marre vendim te vlefshem per zvogelimin e kapitalit themeltar vetem kur marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se  $\frac{1}{2}$  e numrit total te votave. Kapitali themeltar zmadhohet me vendim te ortakeve te pranishem qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e votave.

Zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe ata perfaqesojne.

Ne rast se kapitali i shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, brenda tre muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne keto humbje, ortaket qe perfaqesojne shumicen e cilesuar sipas pikes 11.8. te nenit 11 dhe pikes 10.1. te nenit 10 te ketij statuti, duhet te vendosin ose prishjen e shoqerise, ose zvogelimin e kapitalit me nje vlere me te madhe se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat, por pa e zbritur kapitalin nen shumen minimale, ne perputhje me nenin 70 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

## III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, DHE KONTROLLI I SHOQERISE

### Neni 10

## Asambleja e Ortakeve

Vendimet merren nga asambleja e ortakeve.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe ne vendimet e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet ne keto mbledhje nga nje ortak tjeter ose nga nje mandatmbajtes i cili mund te votoje ne emer te atij qe perfaqeson.

Asambleja mblidhet ne menyre te rregullt dhe mund te thirret ne cdo kohe sipas parashikimeve te neneve 82, 83 dhe 84 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar.

Asambleja thirret nga Kryetari i Asamblese ose ne mungese te tij, nga Administratori. Kryetari i Asamblese emerohet dhe ndryshohet nga Asambleja me shumice te thjeshte. Ai nuk eshte punemarres i shoqerise.

Kryetari i asamblese emerone nje person fizik, ortak ose jo, ne postin e sekretarit. Sekretari mban proces - verbalin e mbledhjes, i cili firmoset nga te gjithet ortaket e pranishem ne mbledhje.

Votimi eshte ne parim i hapur. Me kerkese te nje ose disa ortakeve te pranishem qe perfaqesojne me shume se gjysmen e votave, votimi eshte sekret.

Jane ne kompetencen e Asamblese dhe nuk mund t'i delegohen Administratorit, marrja e vendimeve per sa i perket:

- a. ndryshimi i statutit;
- b. riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likuidimi, shnderrimi;
- c. zmadhimi, zvoglimi i kapitalit;
- d. miratimi i llogarive, raporti vjetor, inventaret, raporti i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit te Asamblese;
- f. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- g. emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- h. te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe ose ky statut i japin shprehimisht Asamblese;

11.8 Asambleja merr vendim me

- a. shumice te thjeshte: me shume se  $\frac{1}{2}$  e votave te ortakeve pjesemarres, ose
- b. shumice te cilesuar: me  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres - sipas parashikimit te nenit te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" te ndryshuar

Asambleja vendos me shumice te cilesuar ne lidhje me :

- a. ndryshimin e statutit

b. transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek nje i trete c. zmadhimin apo zvoglimin e kapitalit themeltar

d. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

e. shperndarjen e fitimeve

Per cdo ceshtje tjeter, Asambleja vendos me shumice te thjeshte.

Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante, qe mbahet ne seline e shoqerise.

## **Neni 11**

### **Administrimi**

Shoqeria administrohet nga Administratori, emerimi i te cilit behet sipas rregullave te Ligjit Nr.9901, pjesa qe ben fjale per sh.p.k.-te.

Administratoret jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje ligjore, per shkelje te statutit apo per faje gjate administrimit te shoqerise.

## **Neni 12**

### **Kompetencat e Administrimit**

Marredheniet midis administratorit/ve, kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e tyre rregullohen nga Akti i Emerimit dhe Statuti.

Administratori/et ka keto kompetenca dhe detyra:

(a) te monitoroje dhe te supervizoje zbatimin e politikave te biznesit;

(b) me kerkese te Asamblese se Ortakeve te marre te gjitha masat ne kompetence te tij dhe ti zbatoje ato;

(c) te siguroje qe Shoqeria zbaton ligjet e aplikueshme per te dhe standartet e duhura te kontabilitetit;

(d) te ekzaminoje dhe te mbaje Librat e Shoqerise, dokumentat dhe asetet;

(e) te siguroje qe librat e auditit dhe te dhenat te tjera te kontrollohen te pakten nje here ne vit nga eksperti kontabel i autorizuar;

(t) cdo te drejte dhe kompetence tjeter per te kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per interes te shoqerise, me perjashtim te atyre rasteve qe ligji dhe/ose ky statut i japin shprehimisht Asamblese.

Administratori/et ka te drejte te caktoje nje ose disa persona te autorizuar per te realizuar pjeserisht apo plotesisht kompetencat dhe detyrat tij te administrimit.

## **Neni 13**

### **Eksperti kontabel i autorizuar**

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar (person fizik apo shoqeri). Ai caktohet me vendim te Asamblese, me shumice te thjeshte.

#### **IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT**

##### **Neni 14**

##### **Viti financiar**

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht viti i pare fillon ne ditën e regjistrimit dhe perfundon ne fund.

##### **Neni 15**

##### **Llogarite vjetore**

Llogarite vjetore, inventari; raporte mbi operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecuara te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga asambleja e pergjithshme.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

##### **Neni 16**

##### **Fitimi**

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha shpenzimet, si edhe fondet e lena rezerve per nxitje ekonomike, per investime per reklame tregtare etj, ndahen ndermjet ortakeve ne perputhje me perqindjen e kapitali themeltar qe ka secili ortak.

##### **Neni 17**

##### **Bilanci**

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

#### **V. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI**

##### **Neni 18**

##### **Likuidimi**

Shoqeria priset me vendim te asamblese me shumice te cilesuar dhe ne perputhje me ligjet ne Republiken e Shqiperise.

Ne rastin e prishjes se kompanise, ajo kryen procesin e likuidimit ne perputhje me ligjet ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

## VI. DISPOZITAT E FUNDIT

### Neni 19

#### Mosmarrveshjet

Per te gjitha mosmarreveshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do te aplikohet Ligji nr .9901, date 14.04.2008" Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare" si dhe Legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

Ky Statut u perpilua dhe firmoset nga te dy ortaket e shoqerise me daten 01.06.2023, ne gjuhen Shqipe ne 4 (Kater) kopje origjinale, secili me te njejten vlere ligjore. Njeri prej tyre depozitohet ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Me daten 1.06.2023, ne Tirane, u hartua dhe u nenshkrua, me vullnetin e lire te Ortakeve z. Jakup Vrioni, Medjan Deda ky Statut i Shoqerise "NEW DENT" Sh.p.k., ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, te ndryshuar dhe Nenin 43 te Ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte ligjore.

#### ORTAKET E SHOQERISE

**JAKUP VRIONI**



**MEDJAN DEDA**

